



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 322, datë 24.12.2019

**PËR
SHPËRNDARJEN E AUTOMJETEVE TË REJA DHE ATYRE NË PËRDORIM NË
SISTEMIN GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61, pika 2 shkronja “dh” dhe në nenin 96 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 30 datë 30.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

I. Shpërndarjen e automjeteve të reja, në sistemin gjyqësor, si më poshtë:

1. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të qëndrojnë 13 (trembëdhjetë) automjete;
2. Në Gjykatën e Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të transferohen 3 (tre) automjete;
3. Në Gjykatën e Posacme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të transferohet 1 (një) automjet;
4. Në Gjykatën e Apelit Gjirokaster të transferohet 1 (një) automjet;
5. Në Gjykatën e Apelit Korçë të transferohet 1 (një) automjet;
6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të transferohet 1 (një) automjet;
7. Në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të transferohet 1 (një) automjet;
8. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec të transferohet 1 (një) automjet.

II. Shpërndarjen e automjeteve që aktualisht janë në përdorim (pronësi) të KLGJ-së, si më poshtë:

1. Në Gjykatën e Apelit Tiranë të transferohet 1 (një) automjet;
2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë të transferohet 1 (një) automjet;
3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë të transferohet 1 (një) automjet;
4. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës të transferohet 1 (një) automjet;
5. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, të transferohet 1 (një) automjet;
6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, të transferohet 1 (një) automjet.

III. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR